



REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

---

**PROCESVERBAL**  
**Nga mbledhja e IX-të për vitin 2011, e Kuvendit Komunal në**  
**Vushtrri, mbajtur më 29.9.2011**

---

Mbledhja është mbajtur në sallën e kuvendit komunal duke filluar në orën **10:15**.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri: Arta Ismajli, Avdullah Halimi, Bahrije Pllana, Besim Jashari, Ergin Sunguri, Esat Beka, Ferit Idrizi, Gani Imeri, Habib Mustafa, Habibe Gërzhaliu, Hajrulla Muli, Islam Krasniqi, Ismet Gashi, Makfirete Ademi, Merjeme Ismajli, Melihate Basholli, Muharrem Shabani, Naile Osmani, Selim Rrustemi, Nysret Gërzhaliu, Pajazit Pllana, Qazim Azemi, Refik Ramaj, Remzije Isufi, Sabit Kadriu, Sabri Ferati, Selvete Sholla, Shpëtim Zhegrova, Syzana Sylja, Tasim Gubetini, Veli Karaça, Vlora Qirezi, Xhemajl Pllana, Xhylsime Feka, Zeqir Hasani.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe: kryetari i komunës, nënkryetari i komunës, drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të ICO-së (Zyra Civile Ndërkombëtare), dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë.

**Refik Ramaj, anëtar i Kuvendit-** në emër të Grupit parlamentar të LDK-së propozoi që pika nr.3 e rendit të ditës të shtyhet për seancën e ardhshme, dhe të kompletohet, të merr formën dhe përmbajtjen e raportit të situatës ekonomiko-financiare, pasi që ky raport e ka vetëm pjesën e dytë të investimeve, kurse për pjesën e parë nuk flet, dhe shtoi se kështu ka qenë edhe vitin e kaluar. Kurse te pika nr.4 kërkoi që në vend të fjalës “planifikim” të bëhet “draft”, dhe shtoi se sipas rregullave në fuqi ky draft-buxhet është dashtë të shqyrtohet më 1 shtator, dhe të shkojë në diskutim publik. Por pasi që nuk janë respektuar këto procedura, dhe pasi që buxheti komunal është i një rëndësie të veçantë propozoi që të formohet një komision i përbërë nga grupet parlamentare, dhe disa pozicione, siç është asfaltimi i rrugëve, e që nuk janë të emërtuara se cilat janë ato, komisioni në fjalë së bashku me drejtorinë të bëjë emërtimin e tyre. Në fund lidhur me pikën nr.8 të rendit të ditës, tha se pasi që është plan i veprimit, është çështje operationale, dhe si e tillë nuk ka nevojë të shqyrtohet në kuvend.

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i Kuvendit-** duke e pasur parasysh rëndësinë e aprovimit të buxhetit komunal, në emër të Grupit parlamentar të PDK-së propozoi që në rend dite të shqyrtohen vetëm këto pika të rendit të ditës: 1, 2, 4, 5, kurse pikat tjera të rendit të ditës të shtyhen për seancën e ardhshme, duke e njoftuar kryetarin e komunës që kjo po ndodh për shkak të mos emërimit të disa shkollave, dhe në rast se nuk bëhet emërtimi i shkollave deri në seancën e ardhshme, Grupi parlamentar i PDK-së nuk do ta votojë rendin e ditës.

**Muharrem Shabani, anëtar i Kuvendit-** tha se për çështje serioze duhet të përgatiten materialet ashtu siç duhet, pasi që një pjesë janë të papërgatitura sa duhet. Pastaj paraqiti vërejtje për kalimin e shumë materialeve, duke mos iu nënshtruar kalimit përmes KPF-së, dhe shtoi se sot ka ardhur një propozim-vendim, i cili nuk është i bazuar dhe nuk është i kompletuar, dhe thuhet “se do të ipen në shfrytëzim pronat e komunës sipas një liste që është pjesë përbërëse e këtij vendimi”, kurse anëtarët e kuvendit nuk e kanë fare listën në fjalë. Gjithashtu, duke iu referuar nenit 2, tha se mungon lista e përmendur në nenin në fjalë, prandaj nuk është askush kundër dhënies së këtyre pronave, por duhet të ketë transparencë të plotë rreth dhënies të pronave, dhe të dihet se për cilat sipërfaqe dhe kultura është fjala, duke shtuar se edhe në arsyetimin e propozim-vendimit duhet të dihet shfrytëzuesi i pronave, e jo pronari. Në vazhdim kërkoi që të hiqet nga arsyetimi ku thuhet që ata që i kanë shfrytëzuar parcelat ilegalisht, atyre po u dashka t’u ipen në shfrytëzim, sepse po stimulohen veprat e kundërligjshme, mirëpo dhënia e tokave në shfrytëzim të bëhet përmes një konkurrence dhe të përfitojë të drejtën e shfrytëzimit të tokës ai që ofron kushte më të mira, dhe në fund kërkoi që propozim-vendimi në fjalë të mos hyn në rend dite, por të kalojë përmes KPF-së, të analizohet mirë, të prezantohen dokumentet e nevojshme dhe pastaj të vjen në kuvend.

**Nasuf Aliu, drejtor i Drejtorisë për Ekonomi dhe Bujqësi-** tha se propozim-vendimi në fjalë është i një rëndësie të veçantë. Pastaj tha se ka më shumë se dy muaj që në bashkëpunim me Drejtorinë e Kadastrit jemi duke evidentuar të gjitha parcelat që janë në pronësi të komunës. Pastaj duke iu referuar nenit 1 të propozim-vendimit në fjalë, tha se është një shkresë shumë voluminoze, në të cilën përfshihen edhe oborret e shkollave, varrezat, lumenjtë dhe shumëçka tjetër, prandaj qëllimi është që të nxjerren vetëm tokat bujqësore dhe kullosat, në mënyrë që të bëhet shpallja e tyre.

**Qazim Azemi, anëtar i Kuvendit-** kërkoi që të bëhet praktikë që rekomandimet e KPF-së të hyjnë në rend dite, dhe disa rekomandime nuk kanë hyrë. Pastaj tha se disa pika të rendit të ditës të përgatitën më mirë, duke shtuar se Informata e Drejtorisë së Arsimit është e mangët. Në vazhdim pyeti Drejtorinë e Arsimit pse 5-6 shkolla të pavarësuar prej vitesh, akoma nuk kanë emra? Pyetja tjetër është se a mbanë Drejtorja e Arsimit drejtor pa kontratë pune, ose me kontratë të skaduar prej muajsh dhe vitesh, ose drejtor me mungesë të përgatitjes së duhur shkollore, duke përmendur shkollat në Skromë, Reznik, Dumnicë e LLugës, Stanoc etj? A ka edhe sivjet klasa me më shumë nxënës, duke shtuar se nuk ka raport as për regjistrimin e nxënësve në shkollat e mesme të larta? Gjithashtu është brengosëse edhe problemi i ujit të pijshëm nëpër shkolla, duke shtuar se në qytet mbi 12.000 nxënës nuk kanë ujë të pijshëm prej orës 8:00-18:00, a është menduar ndonjë alternativë e furnizimit me ujë të pijshëm? Mandej pyeti se a do të fillojë së shpejti funksionimi i fabrikës së ujit në Vushtrri, dhe për zonat rurale a ka dalur shërbimi i Institutit të Shëndetit Kombëtar për të bërë verifikimin, pasi që pusët nëpër zonat rurale e kanë ujin shumë të ndotur dhe është i pasigurt për nxënës? Pastaj pyeti a ka në shkollat fillore mësues të pakualifikuar edhe këtë vit, dhe për këtë kërkoi përgjigje me shkrim, dhe në anën tjetër a ka mësues të kualifikuar që presin në Drejtorinë e Arsimit, dhe a janë shpall të gjitha vendet për ata mësues që kanë qenë të pakualifikuar. Githashtu tha se stafi administrativ në disa shkolla është i ngarkuar, duke përmendur si shembull shkollën e mesme të ulët nr.1, ku për një vend pune të bibliotekistit, punojnë dy punëtor,

kurse është shkolla afër spitalit me 1300 nxënës dhe nuk i ka dy punëtor, prandaj pyeti pse ndodhin këto kontraste?

**Qerim Selimi, drejtor i Drejtorisë për Arsim-** lidhur me emërimin e shkollave, tha se është një Udhëzim Administrativ, të cilin e kemi zbatuar në përpikëri, dhe shtoi se kanë ardhur propozime nga këshilli i shkollave me 7-8 emra, dhe nga këta emra e kemi zgjedhur një emër së bashku me kryetarin e komunës, dhe e kemi proceduar në Ministrinë e Arsimit, por pastaj pasi që ka pas ndërhyrje është ndërprerë, dhe i kemi tërhiqur propozimet nga Ministria e Arsimit, duke konkluduar se duhet të përsëritet procedura, dhe njoftoi se pakënaqësi ka pasur edhe nga anëtarët e Grupit parlamentar të PDK-së, edhe nga familjarët. Pastaj tha se çdo propozim që vjen nga këshilli i shkollës, përsëri do ta procesoj në Ministrinë e Arsimit, dhe shtoi se nuk ekziston asnjë pengesë ligjore për të funksionuar shkollat edhe kështu të pa emërtuara, duke rikujtuar se në shkollat perëndimore shkollat nuk kanë emra, por vetëm kode. Gjithashtu njoftoi se propozimet që i kanë dhënë, kanë qenë propozime të përgjithshme, si: “Dëshmorët e Kombit”, “17 Shkurti”, “7 Shkurti”, “10 Qershori”, kurse po kërkohet që propozimet të identifikohen me emra të dëshmorëve, por në Komunën e Vushtrrisë janë 64 dëshmorë, kurse bëhet fjalë për emërimin e 30 shkollave. Kurse lidhur me zgjedhjen e drejtorëve të shkollave, tha se jemi në fazën përfundimtare për zgjedhjen e tyre, konkursi është përsëritur, kurse fshati Skromë nuk do të ketë më drejtor, pasi që me tri paralele të ndara i ka 45 nxënës, por aty do të jetë një ushtrues detyre. Ndërsa lidhur me kuadrot e kualifikuara, tha se asnjë kuadër në Komunën e Vushtrrisë që është i kualifikuar për gj. angleze, për mësim klasor, ose që është i kualifikuar për drejtime përkatëse në shkolla të mesme profesionale nuk është pa punë. Ndërsa, sa i përket regjistrimit në klasat e X-ta, tha se gjimnazi është regjistruar me 99 % sipas kriterëve të Ministrisë së Arsimit, dhe çdo klasë i ka nga 32 nxënës, ndërsa në shkollat teknike i kanë nga 35 nxënës një klasë, me përjashtim të një klase e cila i ka 37 nxënës.

**Sabit Kadriu, anëtar i Kuvendit-** paraqiti një kërkesë në emër të disa banorëve të fshatit Shtruhërë lidhur me atë se çfarë statusi ka Shtëpia e Kulturës, e cila funksionon në kuadër të shkollës në fshatin në fjalë.

**Besim Jashari, anëtar i Kuvendit-** duke iu referuar rekomandimeve të KPF-së, pyeti se a i kanë shkuar me kohë edhe kryetari të komunës dhe nëse këto rekomandime i ka marrë kryetari i komunës, a i ka shqyrtuar me bordin e drejtorëve, pasi që nga materialet që i kemi nuk po duket se janë marrë parasysht, dhe shtoi se drejtorët e drejtorive kanë pas kohë të mjaftueshme për t'i inkuorporuar rekomandimet e KPF-së.

**Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, Kuvendi me 18 vota “për” , 8 “kundër” , të tjerët “abstenim” miratoi këtë:**

## REND DITE

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja e KK-së, mbajtur më 28.7.2011.
2. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e KK-së, mbajtur më 12.9.2011.
3. Shqyrtimi i Draft-buxhetit dhe projekteve investuese për vitin 2012.
4. Shqyrtimi i Draft-rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2012 (shqyrtimi i dytë).
5. Të ndryshme.

**Bajram Mulaku, kryetar i Komunës-** tha se në bazë të LVL-së, kryetari i komunës është i obliguar, që çdo 6 muaj të raportojë për situatën financiare të komunës, dhe me kërkesë të deputetëve mund të raportohet edhe më shpesh, edhe pse për

situatën financiare, për të hyrat raportojmë në çdo seancë të kuvendit, mirëpo për shpenzimet që bëhen në komunën tonë është e nevojshme të raportojmë sipas ligjit, dhe herën e kaluar u dakorduar që ta shtyjmë këtë raportim, me qëllim që edhe anëtarët e kuvendit të pajisen me raportin në fjalë, dhe për këtë seancë është përgatitur një raport i detajuar, mirëpo nuk u aprovua kjo pikë e rendit të ditës për këtë seancë të KK-së.

**Sami Istrefi, drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike-** duke iu referuar pikës nr.8 të rendit të ditës, tha se dokumenti në fjalë është shqyrtuar dhe është aprovuar nga KPF-ja që të procedohet për kuvend, dhe i njëjti është rekomanduar nga USAID-i që ta ketë edhe vendimin e kuvendit, pasi që komuna participon me disa mjete financiare, dhe së bashku me USAID-in pritet të realizojmë një projekt jashtëzakonisht kapital, e që është rregullimi i shëtitores së “bankinës”, dhe kemi hartuar një plan të veprimit, duke paraparë tri pika kryesore, siç janë: mbrojtja e mjedisit, eliminimi i deponive ilegale, menaxhimi i mbeturinave dhe krijimi i hapësirave të gjelbërta. Në vazhdim tha se tani po rrezikohet një donacion nga një partner shumë i fuqishëm, siç është USAID-i, prandaj shprehi keqardhje që kjo pikë e rendit të ditës nuk u aprovua për t’u shqyrtuar në këtë seancë të KK-së, duke pamundësuar marrjen e vendimit, dhe duke rrezikuar të gjitha përgatitjet që janë bërë brenda 8 muajve.

### **1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja e KK-së, mbajtur më 28.7.2011.**

**Ismet Gashi, anëtar i Kuvendit-** në faqen 9, në diskutimin e tij, kërkoi që në rreshtin 23 të shtohet fjala “zhvillimor”, kurse në rreshtin 24 duhet shtuar fjalën “të fshatrave”.

**Besim Jashari, anëtar i Kuvendit-** në faqe nr.5 në diskutimin e tij, kërkoi që fjala “mbulime” të përmirësohet në dy raste me fjalën “investime”.

**Aprovohet në mënyrë unanime procesverbali i mbledhjes së Kuvendit të Komunës, me vërejtjet nga I.Gashi dhe B.Jashari.**

### **2. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e KK-së, mbajtur më 12.9.2011.**

**Sabit Kadriu, anëtar i Kuvendit-** tha se në faqen nr.4 nuk është diskutimi i tij i plotë, prandaj kërkoi që të plotësohet.

**Aprovohet në mënyrë unanime procesverbali i mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës, me vërejtjen nga S.Kadriu.**

### **3. Shqyrtimi i Draft-buxhetit dhe projekteve investuese për vitin 2012.**

**Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa-** tha se draft-buxheti është përgatitur duke u bazuar në qarkoren buxhetore 01/2012 dhe qarkoren e fundit 02/2012, dhe shtoi se duke u bazuar në qarkoret buxhetore kanë qenë të obliguar t’i mbajnë dy dëgjime publike me qytetarë, të cilat dëgjime janë mbajtur. Pastaj duke u bazuar në qarkoren buxhetore 02/2012 kemi marrë kufijtë final të buxhetit për vitin 2012. Në vazhdim paraqiti sqarime shtesë lidhur me draft-buxhetin në fjalë.

**Zeqir Hasani, anëtar i Kuvendit-** tha se është një risi për buxhetin e vitit 2012, përderisa te kategoritë ekonomike, te pagat gjithmonë ka pasur kufizime buxhetore, kurse tash prej vitit 2012 të gjitha kategoritë ekonomike, duke filluar nga mallrat dhe shërbimet, investimet kapitale, pagat dhe mëditjet, të gjitha do të kenë shtërngime buxhetore, pra nuk mund të lëvizet nga fondet tjera në fondet adekuate. Kurse sa i përket burimit të financimit, shihet se në vitet e ardhshme komuna do të fokusohet në mbledhjen e të hyrave vetanake, të cilat do të përbëjnë 50 % të investimeve

kapitale. Gjithashtu kategoria “mallra dhe shërbime” do të ketë një ulje graduale nëpër vitet e ardhshme, me qëllim të rritjes së investimeve kapitale, pasi që në tri vitet e ardhshme do të ketë shtrëngime buxhetore. Mandej tha se duke analizuar ndarjen buxhetore, shihet se në vitet e ardhshme menaxhmenti komunal së bashku me dikasteret e veta duhet të jetë i koncentruar dhe i angazhuar maksimalisht në mbledhjen e të hyrave vetanake, me qëllim të plotësimit të nevojave të qytetarëve, për arsye se buxheti qendror është në një krizë. Në vazhdim duke iu referuar planifikimit të të hyrave vetanake, te taksat komunale nga firmat thuhet se në vitin 2012 do të jenë 130.000 €, në vitin 2013 do të jenë 210.000 €, kurse në vitin 2014 do të jenë 212.000 €, prandaj kërkoi që të bëhet një korrigjim, pasi që nuk mund të ketë diferencë 100 % të mbledhjes së taksave komunale, kur dihet niveli dhe kapaciteti i bizneseve që operojnë në komunën tonë, prandaj kërkoi që kjo rritje të bëhet te tatimi në pronë, duke shtuar se edhe në KPF ka propozuar formimin e një komisioni, i cili do të bënte rivlerësimin e ekonomive familjare dhe të bizneseve, pasi që ka ndryshime të mëdha në ngarkesat që momentalisht janë duke u bërë. Ndërsa, lidhur me pozicionin “regjistrimi i bizneseve”, tha se dihet që regjistrimi i një biznesi kushton 5 €, dhe nga planifikimi në fjalë del se Drejtoria për Buxhet ka paraparë që të regjistrojë 2.000 biznese brenda vitit, por kjo është e pamundur, pasi që 2.000 biznese nuk janë aktive në Komunën e Vushtrrisë. Në fund kërkoi sqarim pse nuk janë planifikuar të hyra te regjistrimi i automjeteve për vitin 2013 dhe 2014.

**Veli Karaça, anëtar i Kuvendit-** tha se buxhetin në fjalë duhet ta destinojmë për t'i mbuluar të gjitha nevojat më prioritare të popullatës, pasi që këto prioritete financohen nga taksat e tyre. Pastaj apeloi te administrata komunale dhe menaxhmenti që të jenë racional në shpenzimin e buxhetit, dhe të bëhen përpjekje maksimale që të kursehet aty ku mund të kursehet, por jo duke e zvogëluar efikasitetin e punës. Mandej, duke iu referuar investimeve kapitale, tha se ka mundësi që të bëhen planifikime shtesë, dhe përmendi rregullimin e varrezave të qytetit, duke shtuar se është bërë një peticion nga banorët e fshatit Begaj, dhe rikujtoi se para disa viteve ka ekzistuar një projekt për rregullimin e varrezave, poashtu përmendi edhe përmbajtjen e atij projekti. Lidhur me projektet, tha se ka propozuar që mjetet për rrugët e kategorive të katërta, ose nga disa investime që janë paraparë në qytet, por edhe në disa fshatra dhe bashkësi lokale që po investohet me vite të tëra, një pjesë e atyre mjeteve të dedikohet për rrugën Skromë-Bozhlan. Në vazhdim tha se ka fshatra që me vite nuk është investuar në to, kurse fshatarët i kanë boshatisur fshatrat, siç është Skoqna, Shilovica, Bozhlani, kurse në Gumnishtë dhe Skromë kanë mbetur pak familje, duke shtuar se nëse nuk ka familje duke jetuar, ka pasuri natyrore, ka toka të punës, që ato familje duhet t'i punojnë, prandaj propozoi që rruga Skromë-Bozhlan të hyjë në projekt, pastaj fshati Skoqne të lidhet me ndonjë fshat tjetër, në mënyrë që njerëzit të kenë mundësi t'i shfrytëzojnë pasuritë e veta nëpër fshatra. Mandej kërkoi që të punohet në rregullimin e oborreve të shkollave, pasi që oborret e shkollave tona nuk iu përngjajnë vendeve ku fëmijët tanë duhet të edukohen, pasi që janë të mbushura me mbeturina dhe mungon gjelbërimi, mungojnë fushat sportive. Poashtu kërkoi që të ndahen mjete për furnizimin e qytetarëve me ujë të pijshëm, duke shtuar se do të ishte mirë që disa “cisterna” të qëndrojnë tërë kohën në oborret e shkollave, në ato shkolla ku ka shumë nxënës, dhe tha se çështja e furnizimit me ujë të pijshëm nuk pritet të zgjidhet brenda një periudhe të shkurtë, prandaj rikujtoi se për kornizën afatmesme ka propozuar që të shikohen edhe mundësitë alternative për furnizim me ujë të pijshëm, duke njoftuar se është një ujësjellës në fshatin Sllakoc, i cili nuk funksionon, por me pak investime mund të funksionalizohet, dhe kështu problemi i një fshati për furnizim me ujë mund të zgjidhet. Gjithashtu është një burim në Çiçavicë, mbi fshatin Kollë, që ka kapacitete për popullatë prej 7.000 vetash që mund të furnizohen me ujë të pijshëm. Pastaj tha se nuk janë ndarë shumë mjete për rini dhe sport, prandaj propozoi që të bëhet një planifikim më i mirë dhe të ndahen

mjete më shumë për rini dhe sport. Në fund tha se të gjitha këto projekte do të mund të realizohen, nëse revidohen projektet ku është investuar me vite.

**Ismet Gashi, anëtar i Kuvendit-** tha se në vitin 2010 ka marrë një kërkesë prej kryetarit të bashkësisë lokale në Novolan, që ka të bëjë me rregullimin e një rruge për lagjet: “Ferizi, Islami, Peci dhe Hajdari” të fshatit Bruznik, për të cilën banorët e fshatit në fjalë kanë hartuar projektin, i cili iu ka kushtuar 3.000 € dhe e kanë dorëzuar në komunë, dhe kërkesën në fjalë ia ka adresuar kryetarit të komunës dhe Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik më 08.07.2010, që ai projekt të hyjë në prioritet për vitin 2011, por përgjigjja nga strukturat komunale ka qenë se janë pajtuar që kjo rrugë të jetë prioritet kapital për vitin 2011, por ajo rrugë nuk ka hyjë atëherë dhe as tani nuk është, duke shtuar se përsëri e ka një shkresë që kërkohet të hyn në prioritet për vitin 2012 në projekte kapitale, por nuk është fare.

**Bahrije Pllana, anëtare e Kuvendit-** paraqiti dy kërkesa: kërkesa e parë ka të bëjë me grupin joformal të grave deputete, ku kemi propozuar ndarjen e shumës prej 10.000 €, dhe propozoi që kjo shumë të ndahet nga një pjesë e buxhetit të paraparë për shpronësimin e pronës së paluajtshme. Kurse kërkesa e dytë vjen nga fshati Shtitaricë, e që është rregullimi i oborrit dhe rrethojës së shkollës fillore “Bahri Kuqi” në Shtitaricë, pasi që kërkesat nga drejtorja janë bërë me kohë, prandaj kërkoj që kjo të futet në planifikim të buxhetit.

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i Kuvendit-** pasi që mbështeti draft-buxhetin në fjalë në emër të Grupit parlamentar të PDK-së, paraqiti vërejtjen sa i përket asfaltimit të rrugës Kollë-Bruznik, ku janë paraparë 70.000 €, prandaj në emër të Grupit parlamentar të PDK-së propozoi që për këtë rrugë të ndahen 10.000 € për hapjen dhe shtruarjen e kësaj rruge me zhavorr, kurse pjesa tjetër e shumës së mbetur prej 60.000 € t’i dedikohen asfaltimit të rrugëve në fshatin Bruznik, lagjja “Ferizi” dhe “Islami”. Kurse sa i përket fondit për bashkëfinancim, në emër të Grupit parlamentar të PDK-së propozoi që këto rrugë në vitin e ardhshëm të shtrohen me kubëza: rr.”Edmond Hoxha, Avni Klinaku, Kongresi i Manastirit, Mehdi Zabeli, Drini i Bardhë, 2 Maji (skaj magjistrale, lagjja Kurti), Nezir Ymeri, Ejup Kosumi, Ismet Haliti, Trepça, rr. pranë ETC-së, rruga që është aneks i rrugës “Bahri Kuqi” deri te shtëpia e Zeqir Hasanit, rr.Drenica deri te lumi i begajve, rr.Te Potoku, rr. Abedin Ferizi, rr. Bahri Kuqi deri te shtëpia e Menduh Abazit, rr.Isak Halili, rr. Bahri Kuqi deri në fshatin Begaj, rruga deri te shtëpia e Halim Mërnicsës, Shote Galica deri te Bozhlant, Paria e Drenicës, Blerim Saraçi, Jashar Jashari, Halit Salih, magjistrale deri te Avdullah Halimi, Shahin Sylja, dhe rr.Jeton Tërstena-Lumni Surdulli. Ndërsa, sa i përket ndërtimeve të trotuarëve, kemi këto propozime: rr.Drenica me ndriçim, nga rr.Shaban Polluzha përgjatë murit të Poletit deri te rr.Dëshmorët e Kombit në gjerësi prej 3 metrave, nga parku deri te lumi “Tërstena”, Ismajl Qemajli, Ura e Sitnicës deri në fshatin Bukosh, nga hekurudha deri në fshatin Shtitaricë, magjistrale (rr.2 Maji) deri te zjarrfikësit, Lumni Surdulli, Hazir Gjaka” me ndriçim.

**Sabit Kadriu, anëtar i Kuvendit-** pasi që i dha mbështetje draft-buxhetit në fjalë, tha se është dashur të hyjnë edhe disa shpenzime tjera që janë shumë të nevojshme për interesat e qytetarëve të komunës tonë. Pastaj tha se çështja e rrugës e cila të shpie deri te lagjja “Ferizi”, dhe vazhdon deri te lagjja “Islamaj” në Kollë është ngritur disa herë edhe më parë, duke sqaruar se janë dy rrugë, njëra është rruga e vjetër që lidhte Vushtrinë me Duboc dhe Galicë, dhe rruga tjetër që lidh këto lagje, dhe shtoi se lagjja “Islamaj” në Kollë ka mbetur e izoluar, prandaj është mirë të veçohet kjo, pasi që ka krijuar konfuzitet. Në vazhdim tha se hapja e ofiqarive nëpër bashkësi vendore ka qenë një kërkesë e shumë viteve përpara, por akoma nuk janë hapur ofiqaritë në fjalë, dhe çdo qeveri që ka qenë e ka prolonguar këtë çështje, duke shtuar se urbanizimi i bashkësive vendore dhe i fshatrave nuk mund të bëhet pa ekzistencën e së paku një ofiqarie, prandaj duhet të hapen ofiqaritë, dhe në këtë mënyrë banorët do të furnizoheshin më shpejt me dokumentacionet elementare, dhe në këtë mënyrë nuk do të kishte nevojë që njerëzit të presin në qytet me orë të tëra

për marrjen e dokumenteve të tilla, prandaj kjo është dashur të shpejtohet, e jo të mbetet për t'u realizuar në vitin 2014. Në vazhdim tha se ka qenë një kërkesë e tij e kahmotshme për ndërtimin e një biblioteke, duke shtuar se Komuna e Vushtrisë me 100.000 banorë nuk ka bibliotekë për qytetin, prandaj kërkoi që të futet në prioritet ndërtimi i bibliotekës moderne, por njëkohësisht kërkoi që në draft-buxhet të parashihet edhe furnizimi i shkollave me libra, duke kërkuar që të furnizohet me libra të nevojshëm edhe biblioteka aktuale e qytetit. Në fund kërkoi ndërtimin e ngrohtores për qytetin e Vushtrisë, duke shtuar se nuk mund të thuhet se kemi qytet të urbanizuar, përderisa mungon ngrohtorja për qytetin.

**Esat Beka, anëtar i Kuvendit-** propozoi që për fshatrat Duboc dhe Beçiç të ndahen nga 25.000 €, dhe kjo të bëhet nga projekti i rrugës “Dëshmorët e Kombit”

**Islam Krasniqi, anëtar i Kuvendit-** propozoi që në draft-buxhetin në fjalë të futet edhe shtrirja e rrjetit të kanalizimit në fshatin Maxhunaj, pasi që është shumë urgjente, sepse gjendja është e mjerueshme.

**Melihate Basholli, anëtare e Kuvendit-** propozoi që për vitin 2012 Grupi joformal i grave duhet të ketë 10.000 € buxhet. Pastaj tha se ambulanca në fshatin Samadrexhë është vonë të ndërtohet në vitin 2014, prandaj propozoi që kjo të realizohet në vitin 2012. Gjithashtu propozoi që në vitin 2012 të ndërtohet trotuari i rrugës për në fshatin Bukosh, duke filluar nga Ura e Sitnicës, deri te rruga e vjetër e fshatit Duboc.

**Refik Ramaj, anëtar i Kuvendit-** pasi që e mbështeti draft-buxhetin në fjalë, paraqiti vërejtje lidhur me ndarjen e buxhetit nga pozicioni i të hyrave vetjake të cilat po shpërndahen për paga dhe mëditje dhe për mallra dhe shërbime, dhe kjo është brengosëse, pasi që do të ishte mirë që të gjitha të shkojnë në investime kapitale, dhe një pjesë në subvencione. Gjithashtu tha se struktura e investimeve kapitale edhe këtë vit është e mirë, kurse do të duhej të ishte më e vogël përqindja tek pagat, dhe shtoi se nga kategoria “mallrat dhe shërbimet” do të mund të kalonin 2 % tek subvencionet. Kurse lidhur me totalin e të hyrave vetanake, tha se është në kundërshtim me kornizën afatmesme të shpenzimeve, pasi që në raport me planifikimin e të hyrave për vitin 2012, kurse planifikimi për vitin 2013 zvogëlohet për 100.000 €, ndërsa për vitin 2014 këto të hyra zvogëlohen për 260.000 €. Në vazhdim në emër të Grupit parlamentar të LDK-së lidhur me asfaltimin e rrugëve, propozoi që të futen në këtë buxhet lagjja “Ferizi, Peci, Hajdari dhe Islami” në fshatin Bruznik dhe Kollë, gjithashtu të asfaltohet rruga prej pishinës “Delfini” deri te Ura e Podranqes. Në fund duke iu referuar kërkesës për ndarje të mjeteve financiare nga Grupi joformal i grave deputete, tha se grupi në fjalë duhet ta sjellë një elaborat se ku do t'i shpenzojë ato mjete dhe cilat do të jenë prurjet e atyre shpenzimeve.

**Besim Jashari, anëtar i Kuvendit-** paraqiti vërejtje lidhur me ballinën e draft-buxhetit në fjalë, ku është shënuar nga kryetari, përmes drejtorit të BTHF-së, prandaj kjo është gabim pasi që shkresa drejtohet nga drejtori, përmes kryetarit. Pastaj duke iu referuar draft-buxhetit në fjalë, tha se është një dokument i rëndësishëm dhe kërkon një qasje jashtëzakonisht serioze. Në vazhdim lidhur me projektet e planifikuara për vitin 2012-2014, te “administrata” kostoja totale është 52.000 €, kurse nëse bëhet mbledhja e shumave nëpër vite (2012-2014), del se janë 72.000 €. Gjithashtu te “ndërtimi i zyreve të vendit” kostoja totale është 40.000 €, kurse nëse bëhet mbledhja nëpër vite (2012-2014), del se janë 60.000 €, prandaj tha se nuk është e tepërt që një dokument para se t'i paraqitet kuvendit, të rishikohet nga një ekipë e tërë, dhe kjo flet edhe për mungesën e planifikimit. Mandej duke iu referuar “infrastrukturës rrugore” gjelbërimi i qytetit, tha se disa herë po ndahen mjete për gjelbërimin e qytetit, por përmendi si shembull rastin ku të gjithë drunjtë dekorativ të mbjellur te lumi “Tërstenka” dhe bari janë tharë, prandaj kjo tregon për menaxhimin e padrejtë të parasë publike, dhe për këtë duhet të brengosemi të gjithë, por në radhë të parë ata që janë duke e udhëhequr Komunën e Vushtrisë. Lidhur me “riasfaltimin e rrugëve” tha se vihet një shtresë shumë e hollë e asfaltit, kurse vitin e ardhëm gërvishet, dhe prapë një shtresë e hollë, prandaj kjo situatë

bëhet dyshuese se mund të ketë keqpërdorim të parasë publike, me arsyetimin se po ndërtohet diçka. Mandej lidhur me blerjen e një automjeti për pylltari, pyeti se si mund të përkrahet sektori i pylltarisë për t'i mbrojtur pyjet, kur dihet veç sivjet çfarë djegie të pyjeve ka pasur, kurse mungon informata lidhur me vlerën e dëmeve të shkaktuara nga djegia e pyjeve, kurse dihet çfarë vlere paraqesin pyjet për një vend, duke shtuar se nuk ka mundësi që sektori i pylltarisë ta kryejë punën mirë, nëse nuk ka përkrahje dhe mbikëqyrje, dhe është mëkat të ndahen 7.000 € për një automjet për pylltari, kurse 40.000 € të ndahen për automjet luksoz për nevoja zyrtare, duke shtuar se ato automjete nuk përdoren ashtu siç duhet, pasi që shfrytëzohen edhe për nevoja personale. Në fund tha se nëse shikohen investimet kapitale në arsim dhe kulturë, shumat e përcaktuara janë për keqardhje.

**Tasim Gubetini, anëtar i Kuvendit-** në emër të AKR-së propozoi ndërtimin e rrugës në fshatin Tërllabuq, pasi që në këtë fshat nuk ka as shkollë dhe as ambulancë, dhe shtoi se rruga është në gjatësi prej 900 metrave, dhe kushton afër 40.000 €, prandaj propozoi që të zvogëlohet shuma e asfaltimit të rr. Dëshmorët e Kombit, për të mundësuar asfaltimin e rrugës së fshatit në fjalë. Gjithashtu propozoi që të ketë rritje të buxhetit për sport dhe kulturë.

**Qazim Azemi, anëtar i Kuvendit-** tha se në parim e mbështet draft-buxhetin në fjalë, kurse duke iu referuar kodit 470 "Bujqësia, pylltaria dhe zhvillimi rural", tha se Komuna e Vushtrrisë është komunë rurale, por është paraparë një shumë e vogël, prandaj propozoi që shuma prej 85.000 € të rritet mbi 100.000 €, pasi që ka ku të investohet. Mandej duke iu referuar asfaltimit të rr. "Dëshmorët e Kombit", kërkoi që të mos ndahet rr. "Skënderbeu", pasi që edhe kjo rrugë pasqyron imazhin e Vushtrrisë, prandaj kërkoi që të futet në prioritet edhe rruga "Skënderbeu". Gjithashtu tha se edhe Grupi parlamentar i AAK-së i mbështet propozimet që u dhanë për kulturë, rini dhe sport, dhe shtoi se shuma e planifikuar është minimale, prandaj propozoi që të rritet shuma në fjalë. Në fund propozoi që të ndahen mjete edhe për furnizimin e bibliotekave me libra.

**Ergin Sunguri, anëtar i Kuvendit-** propozoi që të rritet buxheti për kulturë, rini dhe sport, pasi që në shumicën e komunave, buxheti për kulturë, rini dhe sport është afër 100.000 €, dhe shtoi se ansambli "Hasan Prishtina" duhet t'i ndahet një buxhet që për çdo vit të merr pjesë nëpër festivale ndërkombëtare. Gjithashtu duhet t'iu ndihmohet klubeve të basketbollit dhe hendbollit pasi që janë në gjendje shumë të rëndë.

**Refik Ramaj, anëtar i Kuvendit-** propozoi që të aprovohet buxheti, por kërkoi që një komision të saktësojë se cilat projekte po hyjnë në dokumentin e buxhetit.

**Hajrulla Muli, anëtar i Kuvendit-** tha se buxheti i planifikuar për bujqësi është i vogël, duke shtuar se Komuna e Vushtrrisë duhet ta ketë Drejtorinë për Bujqësi, me arsyetimin se Vushtrria ka mbi 7.000 hektarë nën sistemin e ujitjes, ka tokën më pjellore në Kosovë, gjithashtu tha se jemi komuna e parë pas luftës në Kosovë, që jemi marrë me bujqësi, dhe që kemi eksportuar patate.

**Xhylsime Feka, anëtare e Kuvendit-** tha se jemi për aprovimin e buxhetit, i cili është i hartuar në mënyrë gjithëpërfshirëse, dhe kontribuon në plotësimin e nevojave të të gjithë qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë. Pastaj pyeti se a do të hyjë në draft-buxhetin në fjalë edhe propozimi për ndarjen e 10.000 € për Grupin joformal të grave deputete?, dhe shtoi se disa nga aktivitetet e grupit në fjalë do të jenë: shërbime për avancimin e gjinisë femërore, posaçërisht femrës intelektuale; organizimi i tryezave të ndryshme; disa kontribute për reforma zgjedhore; realizimi i disa projekteve nëpër shkolla, në veçanti për fëmijët që kanë neqecje në shkrim dhe lexim, prandaj kërkoi që shuma e kërkuar në fjalë të hyjë në draft-buxhet.

**Bajram Mulaku, kryetar i Komunës-** tha se planifikimi që është bërë për vitin e ardhshëm nga Ministria e Financave për Komunën e Vushtrrisë ka qenë i rënduar sidomos për grantin e të hyrave vetanake. Pastaj tha se në vitin 2009, për vitin 2010 kanë qenë të planifikuara mbi 800.000 €, kurse me rishikim i kemi rritur të hyrat mbi



1 milion euro, kurse Ministria e Financave për këtë vit në të hyra vetanake i ka shtuar më shumë se 100%. Pastaj lidhur me planifikimin tha se më mirë është të planifikohet më pak, e të tejkalohet planifikimi, se sa të planifikohet më shumë, e të mos mund të realizohet ai planifikim. Në vazhdim njoftoi se ka paraqitur vërejtje në Ministrinë e Financave, pasi që nuk është planifikim i drejtë për Komunën e Vushtrrisë, në raport me komunat tjera, dhe shtoi se Komunës së Vushtrrisë iu është zvogëluar granti qeveritar, kurse është rritur granti i të hyrave vetanake, por përsëri duhet angazhuar që të realizohet ky grant i të hyrave vetanake. Ndërsa, duke iu referuar planifikimit të këtij buxheti, tha se në këtë vit është bërë planifikimi më i mirë i mundshëm, dhe ka pasur transparencë të plotë, është mbajtur takim me qytetarë, takim me Grupin parlamentar të PDK-së, gjithashtu janë realizuar shumë takime me anëtarët e qeverisë komunale. Mandej duke iu referuar asfaltimit të rrugëve nëpër fshatra, tha se gati çdo fshati i kemi krijuar qasje në asfalt, por akoma nuk kemi arritur të depërtojmë deri në Shalë. Gjithashtu tha se sikur të ishte shtruar rruga deri në Vesekoc-Kurillë për çdo vikend do të kishte vizitues, dhe familjeve të atyre fshatrave do t'ua lehtësonim qarkullimin, por edhe do të krijoheshin kushte për t'u zhvilluar blegtoaria.

**Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit-** i përmendi propozimet që u paraqiten nga anëtarët e kuvendit për t'i inkorporuar në buxhetin në fjalë, duke filluar nga projekti që ka qenë rruga Kollë-magjistrale për t'u lidhur me Skënderaj, për të cilin u propozua që prej 70.000 € në këtë projekt të investohen 10.000 € vetëm sa për ta bërë hapjen, kurse të asfaltohet pjesa ku ka banorë; propozimi tjetër është që për fshatin Tërllabuq të vazhdohet rruga duke i ndarë edhe 30.000 €, duke i hequr nga projekti rr."Dëshmorët e Kombit"; propozimi për fshatrat Duboc dhe Beçiç është që t'iu ndahen nga 25.000 € për rregullim të infrastrukturës rrugore, përkatësisht kanalizim; propozimi për kanalizim në fshatin Maxhunaj, për të cilin janë planifikuar 5.000 €, kurse propozoi që t'i shtohen edhe 15.000 €, duke ua marrë nga 5.000 € këtyre projekteve në: Tërllabuq, Duboc dhe Beçiç; kurse lidhur me kërkesën e Grupit joformal të grave deputete, 10.000 € do t'iu ndahen nga subvencionet; në vazhdim përmendi rrugët dhe trotuarët për t'u shtruar në kubëza, e që më parë i propozoi shefi i Grupit parlamentar të PDK-së për shtruarje në kubëza me participim nga ana e qytetarëve.

**Bajram Mulaku, kryetar i Komunës-** njoftoi se ka kërkuar nga drejtori i buxhetit që të rezervohen 100.000 € për bartje të nxënësve, pasi që drejtoaria në fjalë nuk mund ta mbulojë në fondin për mallra dhe shërbime në vlerë prej 150.000 € për bartje të nxënësve, dhe të njëjtën shumë nuk kemi të drejtë ta fusim në investime kapitale, kurse Ministria e Financave po kërkon që me mjete financiare të komunës ta bëjë bartjen e nxënësve, prandaj propozoi që nëse ka mundësi 100.000€ të barten në subvencione, me dedikim për bartje të nxënësve.

**Muharrem Shabani, anëtar i Kuvendit-** lidhur me prioritetet, tha se është obligim ligjor ndaj komuniteteve që kanë paguar tatimin në pronë, prandaj atyre duhet t'u ipet prioritet ndërtimi i infrastrukturës. Pastaj tha duhet të ketë një zhvillim harmonik të komunës në të gjitha anët e saj, duke investuar me projekte të ndryshme. Në vazhdim duke përmendur fshatin Stanoc i Ulët, tha se ka raste që për një shtëpi të vetme është asfaltuar rruga, kurse ka lagje, siç është lagjja "Duraku" e cila në tërësi është e paasfaltuar. Gjithashtu kërkoi t'i ipet prioritet edhe asfaltimit të rrugëve në lagjet e vjetra të qytetit, duke e mbështetur propozimin që të ketë edhe një përqindje të participimit të qytetarëve, kurse duhet të jetë gjithmonë kriter bazë pagesa e tatimit në pronë.

**Veli Karaça, anëtar i Kuvendit-** propozoi asfaltimin e rrugës Bozhlan-Skromë, duke shtuar se ka fshatra në të cilat janë bërë 5-6 investime, por njëkohësisht ka edhe fshatra që akoma nuk janë të lidhura me rrugë të rendit të IV-të, prandaj kërkoi që t'i ipet prioritet rrugës në fjalë, pasi që ua mundëson fshatarëve punimin e tokave, dhe

zhvillimin e blegtorisë. Gjithashtu kërkoi që të vazhdohet me realizimin e projektit të varrezat e qytetit.

**Bajram Mulaku, kryetar i Komunës-** njoftoi se është duke u realizuar projekti për varrezat e qytetit, në mënyrë që qytetarët të kenë qasje më të lehtë në varreza, duke shtuar se gjendja e varreza të qytetit është e keqe, mirëpo në bashkëpunim me Bashkësinë Islame do ta hapim një pus të varrezat, dhe në këtë mënyrë do të ujiten varrezat sa herë që të jetë e nevojshme, por njëkohësisht do të ketë edhe gjelbërim.

**Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit-** përveç atyre propozimeve që përmendi më herët, vazhdoi edhe me këto propozime që u paraqitën gjatë diskutimit të kësaj pike të rendit të ditës: 100.000 € që janë të destinuara për transportin e nxënësve të vendosen në subvencione, me dedikim për transportin e nxënësve.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:**

***Me këtë vendim aprovohet buxheti i Komunës së Vushtrrisë dhe lista e projekteve prioritare për vitin 2012, konform Qarkores Buxhetore 2012/02 të MEF-it, dt. 27.06.2011.***

#### **4. Shqyrtimi i Draft-rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2012 (shqyrtimi i dytë).**

**Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa-** tha se në bazë Qarkores Buxhetore 01/2012 është obligative që në rastin e aprovimit të buxhetit për vitin 2012, të aprovohet edhe Rregullorja për Tatimin në Pronë, duke shtuar se draft-rregullorja në fjalë ka qenë në diskutim publik, dhe në Zyrën Ligjore për interpretim, dhe kjo draft-rregullore është konform akteve nënligjore për tatimin në pronën e paluajtshme, dhe me sistemin të cilin e ka aktualisht në shfrytëzim Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

**Ismet Gashi, anëtar i Kuvendit-** rikujtoi se ka dhënë vërejtje edhe në të kaluarën, pasi që çdo dokument që vjen nga debati publik në shqyrtim të dytë, duhet të shoqërohet me një dokument përcjellës, në të cilin do të përshkruhej ecuria e debatit publik. Pastaj tha se prej 9 neneve që i ka draft-rregullorja në fjalë, 5 prej tyre i referohen Ligjit për Tatimin në Pronë, përkatësisht udhëzimit administrativ, dhe nëse një qytetar e merr këtë rregullore nuk do ta kuptojë përmbajtjen e saj. Mandej lidhur me nenin 1.2, duke iu referuar Udhëzimit Administrativ nr.03/2011, tha se ky udhëzim administrativ thotë se gjendja e pronës ndahet në 5 kategori dhe përcakton koeficientët e gjendjes së ndërtesës, prandaj tha se ky udhëzim administrativ është dashur të jetë në harmoni me Ligjin mbi Tatimin në Pronë, pasi që nuk është në një harmoni të tillë, duke shtuar se Ligji mbi Tatimin në Pronë ia lejon kuvendit të komunës të caktojë tarifën tatimore mbi pronën, baza vjetore në shkallën prej 0.05%-1% të vlerës së pronës në treg, kurse udhëzimi thotë deri në 1.1%. Në vazhdim tha se në draftin e parë kanë qenë të përmendura edhe zonat, kurse në këtë draft vetëm thuhet se janë 5 zona, mirëpo qytetari nuk do të mund ta dijë se ku a ka objektin, prandaj si të tillë, Grupi parlamentar LDK-së nuk do ta përkrah draft-rregulloren në fjalë.

**Muharrem Shabani, anëtar i Kuvendit-** duke iu referuar draft-rregullores në fjalë, tha se mungojnë zonat, prandaj qytetarët nuk e dinë se në cilën zonë bëjnë pjesë, dhe sa është përqindja në zonat e caktuara, dhe shtoi se ka nevojë që kjo draft-rregullore të plotësohet akoma. Gjithashtu nuk dihet sa është koeficienti i ngarkesës, apo tarifa tatimore, a janë të njëjta me vitin paraprak, ose janë më të vogla apo më të mëdha, duke përkrahur edhe vërejtjen e dhënë se draft-rregullores i mungon një akt përcjellës që do ta shpjegonte ecurinë e debatit me qytetarë. Në fund tha se është e nevojshme që të krahasohet gjendja, pasi që nuk është bërë regjistrimi real.

**Esat Beka, anëtar i Kuvendit-** tha se Grupi parlamentar i PDK-së e përkrah draft-rregulloren në fjalë, dhe shtoi se e njëjta është e harmonizuar me Udhëzimin Administrativ nr.03/12.

**Besim Jashari, anëtar i Kuvendit-** paraqiti vërejtje se draft-rregullores në fjalë i mungon faqja nr.3 dhe nr.5, prandaj ka qenë e pamundur ta shqyrtojë ashtu siç duhet.

**Zeqir Hasani, anëtar i Kuvendit-** tha se në KPF ka paraqitur disa vërejtje dhe sugjerime lidhur me draft-rregulloren në fjalë, ku ka kërkuar që te pishinat dhe fushat sportive të zvogëlohet norma e tatimit, për shkak se kanë punë dhe kapacitet sezonal. Gjithashtu kemi kërkuar që t'i shtohet edhe një nen kësaj rregulloreje, ku do të bëhet rivlerësimi i ekonomive familjare dhe bizneseve në çdo fundvit.

**Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa-** sqaroi se në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës është Ligji nr.03/L-204, dhe në kuadër të kësaj janë udhëzimet administrative të dalura nga ky ligj, dhe është një formë standarde për të gjitha komunat. Kurse lidhur me koeficientët, tha se në data-bazë të tatimit në pronë është i përcaktuar decidivisht koeficienti për të gjitha komunat.

**Sabit Kadriu, anëtar i Kuvendit-** duke iu referuar draft-rregullores në fjalë, tha se duhet të vijë e kompletuar, e jo me mungesë të faqeve, dhe nuk ka të keqe nëse kthehet përsëri në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa për t'u kompletuar. Gjithashtu është e nevojshme të jenë edhe zonat dhe përsëkrimet për secilën zonë veç e veç.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 25 vota “për”, 7 “kundër”, të tjerët “abstenim” vendosi me sa vijon:**

**Aprovohet Rregullorja për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2012, me vërejtjet dhe sugjerimet e anëtarëve të Kuvendit.**

## **5. Të ndryshme,**

### **Pyetjet e anëtarëve të Kuvendit:**

**Besim Jashari-** duke u bazuar në informata jozyrtare në Komunën e Vushtrrisë ka pasur djegie të pyjeve, prandaj kërkoj informatë të saktë lidhur me vlerësimin e dëmit që është shkaktuar nga djegia e pyjeve. Gjithashtu shprehu shqetësimin e tij, pasi që në qytet dhe jashtë qytetit janë të vendosura një numër i konsiderueshëm i antenave të telefonisë, kurse jozyrtarisht thuhet se rrezatimi që lirojnë antenat është i dëmshëm për shëndetin e njerëzve, prandaj kërkoj informatë në lidhje me çështjen në fjalë, dhe njëkohësisht kërkoj që nëse janë të dëmshme, të merren masa dhe të stopohen.

**Pajazit Pllana-** kërkoj informatë për gjendjen shëndetësore epidemiologjike për periudhën 9-mujore.

**Esat Beka-** kërkoj informatë për zënien e tokës së bukës, duke filluar nga ura e lumit “Sitnica” deri te binarët e trenit, dhe shtoi se prapë kanë filluar të hedhin mbeturina në tokat e bukës.

**Muharrem Shabani-** duke iu referuar analizave që kanë bërë institutet e ndryshme, në mesin e tri komunave më të apostrofuara të Kosovës që përdoret më së shumti droga, është edhe Komuna e Vushtrrisë, prandaj e kemi obligim që të angazhohemi ne si kuvend dhe të gjitha institucionet tjera kompetente në Komunën e Vushtrrisë, duke përfshirë policinë, Drejtorinë për Shëndetësi dhe Drejtorinë për Arsim për të zbutur dhe parandaluar një dukuri të tillë tepër negative.

**Refik Ramaj-** shprehu indinjatën e tij në emër të Grupit parlamentar të LDK-së për injorimin e kërkesës të parashtruar kohë më parë që të bëhet një hetim analitik rreth kontesteve të humbura gjyqësore të komunës. Pastaj kërkoj informatë rreth sigurisë në komunikacion, pasi që po ka fatalitetet brenda qytetit.

**Makfirete Ademi-** pyeti pse kërkohet pagesë nga OJQ-të që punojnë me fëmijët, duke përmendur OJQ-në “JAK”, e cila fiton donacione nga jashtë për t'i mbështetur fëmijët e komunës tonë, por nëse fëmijët dëshirojnë të mbajnë ndonjë program, atëherë i detyrojnë fëmijët që të paguajnë për sallë të Shtëpisë së Kulturës.

**Xhemajl Pllana**- tha se kërkesa e tij ka qenë që të mbahet një seancë e kuvendit lidhur me ndërtimet e egra nën sistemin e komasacionit. Kërkesa tjetër ka qenë rreth humbjeve të kontesteve gjyqësore të Komunës së Vushtrrisë. Gjithashtu edhe një kërkesë tjetër e kahmotshme është që të rregullohet infrastruktura e sallës së kuvendit, pra të rregullohet çështja e zërimit.

**Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit**- lidhur me vërejtjen e Xh.Pllanës, u përgjigj se në bazë të Rregullores së Kuvendit, për atë pikë të rendit të ditës duhet të thirret seancë e jashtëzakonshme nga anëtarët e kuvendit, duke iu drejtuar përmes kërkesës kryesuesit të kuvendit, por kërkesa e tillë nuk është bërë.

**Bajram Mulaku, kryetar i Komunës**- duke iu referuar kërkesës për rregullimin e infrastrukturës në sallën e kuvendit, tha se nuk ia vlen të investohet tani, pasi që brenda këtij viti do të fillojnë punimet për ndërtimin e objektit të ri të komunës, dhe brenda një viti pritet finalizimi i objektit në fjalë.

**Mbledhja përfundoi në orën 14:35.**

**Procesmbajtësi:**  
**Albanez Tahiraj**

**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Ferit Idrizi**

**Lektore:**  
**Vlora Krasniqi**